**KËRKESË**
**Nr. 500/8, datë 23.12.2021**

**PËR MARRJE NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURISË**

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik, të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga shpimi i pusit 'Shpirag 4' dhe faciliteteve ndihmëse".

Subjekti kërkues i këtij projekti është shoqëria "Shell Upstream Albania".

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në shoqërinë "Shell Upstream Albania", si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive është 1,474,117 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
**Erlis Hereni**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "SHPIRAGU 4" DHE FACILITETET E TIJ

| Nr. | Pronari | Fshati | Rrethi | ZK | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. $m^2$ që merret në përdorim të përkohshëm | Çmimi /$m^2$ | Vlera totale (lek) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Antik Jashar Hoxha<br>Gorios Jashar Papa<br>Luftar Feim Dosti<br>Vezire Jashar Dishnica<br>Bahrie Jashar Toska<br>Bujar Jashar Moskaj<br>MyzaferI Jashar Sadikaj<br>Niko Jashar Xhakaj | Mbreshtan | Berat | 2634 | 64/4 | Arë | 3,708 | 124.756 | 925,190 | Konfirmuar nga ASHK-ja. |
| 2 | Sefedin File Hoxha | Mbreshtan | Berat | 2634 | 64/7 | Arë | 2,200 | 124.756 | 548,926 | Konfirmuar nga ASHK-ja. |
| | **Totali** | | | | | | **5,908** | | **1,474,117** | |

Shënime.

1. Për tokën "arë", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".